



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

NË EMER TË POPULLIT

P.nr.610/2017

Gjykata Themelore ne Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm Gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit N.D nga ... me vendbanim ne ... për shkak te veprës penale: Mos raportimi ose raportimi i rreme i pasurisë, i te ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 par 2 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovicë PP.II.nr.610/2017 te datës 30.10.2017, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 30.07.2019, ne mungese të PTH, në prezencë te të pandehurit ne te njëjtën dite, publikisht shpall ndërsa me datën 31.07.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: N.D , nga i ati A. , e ëma A. , e gjinisë M., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne ... , shqiptar, kosovar, ka te kryer fakultetin “Menaxhment” i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, ne vitin 2015 ka qene Anëtarë i Bordit te Drejtoreve ne Sh.A “...” me pare i padënuar, ndaj tij nuk ka te zhvilluar procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Ne cilësinë e zyrtarit te larte publik – Anëtare i Bordit te Drejtoreve ne Sh.A “...”, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 5 te Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë se Zyrtareve te Larte publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për periudhën kohore prej 01.01.2015 gjer me 31.12.2015, ne atë mënyrë qe me rastin e deklarimit te pasurisë ne formularin me nr.... nuk e ka deklaruar pasurinë-biznesin e regjistruar ne emër te tij N.N.T “....” me nr.... qe gjendet ne rr “...” ne ..., edhe për kundër faktit se ka qene i obliguar sipas ligjit te beje një gjë te tille.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Mos raportimi ose raportimi i rreme i pasurisë, i te ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 par 2 te KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,46,73, dhe 437 par.2 te KPRK-ës , e lidhur me nenin 450 dhe 453 te KPP-ës e:

G J Y K O N

ME DENIM ME GJOBË në shumë prej 200 euro (dyqind euro), DHE ME DENIM BURGU ne kohëzgjatje prej 3 /tre/ muajve i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes së aktgjykimi i akuzuari ka dhanë pëlqimin që dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me të holla.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 47 të Kodit të Republikës së Kosovës.

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj ia ZAVENDËSON ME DENIM ME GJOBË, ashtu që i pandehuri N.D, obligohet që të paguaj dënimin me gjobë në tersi shumë prej katërqind (400) Euro.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e cekur, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK –ës deri zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro (njëzet) euro për një ditë të kaluar me burg.

Obligohet i akuzuarit që të paguajë shpenzimet procedurale dhe atë ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 /njëzet euro/, ndërsa për kompensimin e viktimave te krimin shumen prej 30 /tridhjetë euro/ te gjitha këto është i obliguar ti paguaj ne afate prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.664/2017 te datës 30.10.2017, kundër te pandehurit N.D nga ... me vendbanim ne ..., për shkak të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rreme i pasurisë, i te ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 par 2 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtim fillestar me dt. 30.07.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: E ndjej veten fajtores për veprën penale qe me vihet ne barre sipas aktakuzës, shprehi keqardhje për këtë raste qe ka ndodhur, i premtoj gjykatës qe e te ardhmen do te jem i kujdesshëm, qëllimi im nuk ka qene qe te mbaj te fshehur asgjë ndaj shtetit lidhur me deklarimin e pasurisë.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi: I propozoj gjykatës qe te pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ngase pranimi i fajësisë ishte i vullnetshëm, pa presion dhe se i njëjti bazohet ne provat te cilat gjenden ne shkresat

e lendes e me rastin e shqiptimit te dënimit gjykata pranimit e fajësisë ta merr si rrethane lehtësuese.

Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimit e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimit i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimit e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimit i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimitin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti i policisë i dt. 20.04.2017, gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve te tjera te dt. 15.05.2017, formulari për deklarimin e pasurisë 31.03.2016, me te dhënat personale te deklaruesit, funksionet ose aktivitetet e tjera qe i kryen zyrtari i larte publik, pasurit e luajtshme tremijë euro, posedimi i letrave me vlere, te ardhurat personale për vitin, formular për deklarimin e pasurisë te dt. 19.01.2016, formulari për deklarimin e ndryshimeve te gjendjes se pasurisë te dt. 30.03.2012, ndryshimi i gjendjes se pasurisë se luajtshme, ARBK, e dt. 25.07.2016, informatat mbi biznesin e dt. 04.12.2008, administrata tatimore e Kosovës, shkrese ,gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve te tjera , dorëzimi i dokumenteve ne AKK e dt. 15.02.2017, historiati i llogarisë-banka ekonomike SH.A, ..., si dhe vështrimi i shkresave tjera te lendes, nga te gjitha këto si dhe nga pranimit i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për te cilën ngarkohet sipas aktakuzës.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashte) muaj deri ne 5(pesë) vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimitin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaronte se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale, si rrethane tjetër gjykata pate parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes dhe i pa pune. Si rrethanë renduese gjykata mori mënyrën e kryerjes se veprës penale dhe karakteristikat e kryerësit te veprës penale. Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit, nga se do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zëvendësimit të dënimit me burg me dënimin me gjobe, bazuar në nenin 47 të KPRK-ës, ku thuhet se kur gjykata shqipton dënim me burg deri në gjashtë muaj, gjykata njëkohësisht mundet të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobe, me pëlqimin e personit të dënuar. E në rastin konkret, pasi që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar që dënimi me burg që gjykata ia ka shqiptuar të pandehurit t'ia zëvendësojë me dënim me gjobe, në këto rrethana gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale- paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 Euro të gjitha këto është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata të dëmtuarit i ka udhëzuar në konteste të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P. nr.610/2017 dt.31.07.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari :
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë në ankese në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.